



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 10 shkurt 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 11, datë 05.02.2021 “Miratimin e udhëzimit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin e mbulimit nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv (OSHMA) të fushatës zgjedhore”. **(Vendimi nr. 05, datë 10.02.2022)**
2. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e AMA-s, nr. 97, datë 21.12.2021, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2022”, të ndryshuar. **(Vendimi nr. 06, datë 10.02.2022)**
3. Miratimin e disa ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “RRTL-OTT” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP (OTT) “RRTL-OTT”. **(Vendimi nr. 07, datë 10.02.2022)**
4. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Elion Boriçi, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Brado” dhe reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në “Njësinë administrative Labinot-Fushë”. **(Vendimi nr. 08, datë 10.02.2022)**
5. Miratimin e disa ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “MASA GRUP 2009” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Masa Grup”. **(Vendimi nr. 09, datë 10.02.2022)**
6. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Tema Tv” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet “Tema Televizion”. **(Vendimi nr. 10, datë 10.02.2022)**
7. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës të subjektit person fizik Thodhori Dukshi, për subjektin audioviziv privat vendor “TV Saranda”. **(Vendimi nr. 11, datë 10.02.2022)**
8. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës të shoqërisë “RTV-RE.AL” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “TV RE.AL”. **(Vendimi nr. 12, datë 10.02.2022)**

AMA në këtë mbledhje u njoh me angazhimin e deritanishëm të autoritetit për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audio/Audioviziv për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 06 mars 2022, në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 10 shkurt 2022